

STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE
"GIFT BY ANIDA" SH.P.K.

Sot më datë 18/02/2025 në Tiranë ishin prezent personalisht ortaku themelues:

Z. Shkëlzen Krajku shtetas shqipëtarë, lindur ne Tiranë me 13.11.1993, atësia Shpëtim dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. J31113055T.

Kam vendosur të themeloj shoqërinë "GIFT BY ANIDA" Sh.p.k dhe kam vendosur te miratoj dhe të nënshkruaj statutin dhe akt themelimin e shoqërisë në përputhje me ligjin e ri që rregullon organizimin e shoqërive tregtare me terma si me poshtë:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "GIFT BY ANIDA" Sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë por duke mos u kufizuar në:

- Marketing digital.
- Website, sponsorizime.
- Marketing rrjetesh sociale, menaxhim personazhesh me influence, organizime konkursesht ne rrjete sociale. Brand-im.

NENI 2

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj **"GIFT BY ANIDA" Sh.p.k.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën **Rruga Soktrat Miho, Pallati Jolla, Shk.A,**

Kati 1, Hyrja.3, Yzberisht, Tiranë, Shqipëri.

Numër kontakti: **+355 695896850.**

Email: **shkelzen.krajku@gmail.com**



NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa here, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4

Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria ka vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 5

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë dhe të lihen me trashëgimi me anë të vendimit të ortakëve.

NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbyllja e këtyre detyrimeve apo nga përmbyllja e tyre përtej afateve përkatëse.



Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejte të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e percaktuara në Statut dhe në ligj. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të percaktuar në Nenin 1.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE

NENI 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 10.000 (Dhjetë mijë) lek, i ndarë në 1 (një) kuota **Z. Shkëlzen Krajku** zotëron 1 kuota të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 10.000 (Dhjetë mijë) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku në total.

NENI 8

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimise;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.



NENI 9

Fitimi ose transferimi i kuotave

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

Fondet rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjate veprimtarisë së saj.

NENI 12

Përdorimi i të ardhurave neto

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdorët nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 13

Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14

Plani financiar

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me ate të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kane të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 16

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria do të shpërndajë fitimet ortakëve në fund të vitit financiar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja e Ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori / Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kane pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 17

Asambleja e Përgjithshme



Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
5. përcaktimin e shperblimeve per administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël te autorizuar.
6. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëllimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 18


Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here që mbledhja është e nevojshme per të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë së pergjithshme thirret të paktën një here në vit. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% te totalit të votave në asamblenë e pergjithshme të shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kane një vlerë me të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kane vlerë me të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



NENI 19

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo me vonë se 15 ditë përpara dates së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si me sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsise.

NENI 20

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me sipër, asambleja mbledhet perseri jo me vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Për ceshtjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdherojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 21

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverball duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverballit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes se asamblesë së përgjithshme.

Procesverballi i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 22

Administratoret

Asambleja e përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizik si administratorë të shoqërisë.

Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administratori i Shoqërisë "GIFT BY ANIDA" Sh.p.k, është Z. **Shkëlzen Krajk**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 13.11.1993, dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. J31113055T i cili është zgjedhur për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërteritjeje duke filluar nga 20.02.2025 - 19.02.2030

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;



5. Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit;
 7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 9. Therrasin asamblesën e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
- Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.
- Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.
- Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 24

Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i pershtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e pershtatshme. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 25

Ekspertët Kontabël

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.



Nuk mund të ngarkohen me detyren e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VI. MARREDHENIET E PUNES

NENI 26

Marredheniet e punes

Marredhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

NENI 27

Pergjegjesite e te punesuarve

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VII. PRISHJA E SHOQERISE. LIKUJDIMI

NENI 28

Prishja e shoqerise

Kjo Shoqëri do të prishet në rastet kur:

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykatë.

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 29

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykates zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakeve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si me sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendres Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të pare dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.

Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendres Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 30

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të paperfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykates përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 31

Bilancet

Likuiduesi për gatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc perfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat me shumë se një vit, likuiduesi për gatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.



NENI 32**Shperndaria e aktiveve**

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kane në ndarjen e fitimeve, me perjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

Pasuritë, që i jane dhëne shoqërise me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare të Regjistrimit per përfundimin e likuidimit dhe kërkon cregjistrimin e shoqërisë.

VIII. DISPOZITA TE FUNDIT**NENI 33**

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 34

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në kete Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me te në fuqi në Republiken e Shqiperise.

ORTAKU I VETËM

Shkëlzen Krajku

